

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BEA TRAVEL” SH.P.K.**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME
PJESA I
Neni 1
Ortakët Themelues**

Sot, në Tiranë, më datë 13.04.2022, është i pranishëm ortaku i mëposhtëm i cilët është dakort të themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar:

1. Zj. **Anxhela Belaj**, e bija e Dritan, lindur në Vlorë, më 11.10.1997, banuese në Rr. Rruga Bilal Sina, Pall. Salillari, Nr. 2 Kati 6, Tiranë, e identifikuar me anë të letërnjoftimit me nr. personal J76011076T, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar

Me nënshkrimin e këtij Akti Themelimi, nënshkruesi dhe themeluesi i saj merr përsipër të realizojë e të respektojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga klauzolat e mëposhtme, të cilat do të specifikohen gjerësisht në Statutin e shoqërisë.

**Neni 2
Emri**

Emri i shoqërisë është: **“BEA TRAVEL” sh.p.k.**, (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

**Neni 3
Selia e Shoqërisë**


- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Tiranë, Rruga Abdyl Frashëri, Vesa Center, Kati 0.
- 3.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**Neni 4
Forma ligjore**

Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, dhe rregullohet prej këtij ligji, dhe statutit të shoqërisë si dhe prej çdo dispozite tjetër ligjore të aplikueshme.

**Neni 5
Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar kohore.



Neni 6
Objekti i Shoqërisë

- 6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë konsiston në kryerjen e të gjitha veprimtarive të pranuar në nivel kombëtar.
- 6.2 Aktiviteti kryesor i Shoqërisë do jetë:
- Agjensi udhëtimi;
 - Ushtrimi i aktiviteteve në fushën e turizmit dhe të udhëtimeve e transportit turistik.
 - Organizimin e udhëtimeve dhe pushimeve individuale ose kolektive për shtetasit shqiptarë dhe të huaj brenda dhe jashtë vendit dhe ndërmjetesimin për shitjen e produkteve turistike në të gjitha format e tij.
 - Shërbime që mund të ofrohen në rastin e udhëtimeve dhe pushimeve si: Rezervimi i vendeve të fjetjes në njësitet akomoduese turistike si hotele, vila etj. Rezervimi dhe shitja e biletave për linjat ajrore dhe detare etj. Rezervimi i vendeve, mjeteve të transportit turistik. Venja në dispozicion me qera pjesore ose totale e këtyre mjeteve. Porositja e ushqimit në restorante turistike.
 - Organizimi i vizitave në qytete, muze, monumente historike-kulturore, natyrë etj.
 - Shërbime guide dhe të perkthyesve etj.
 - Dhënia e informacioneve për turizëm, udhëtime, objekte social- kulturore etj.
 - Ndërmjetesim me shitësit kryesorë në produktet turistik.
 - Kryerjen e çdo veprimtarie tjetër të lejuar nga legjislacionin në fuqi.
- 6.3 Më tej, Shoqëria mund të zhvillojë çdo aktivitet të cili nuk lidhet drejtpërdrejtë me aktivitetin e shoqërisë pa e përcaktuar atë me saktësi.

PJESA II
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË DHE KUOTAT


Neni 7
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 100 (njëqind) dhe është i përbërë nga 1 (një) kuotë me zotëruese Anxhela Belaj, që përfaqëson 100 % të kapitalit të regjistruar.

PJESA III
ORGANIZIMI

Neni 8
Administrimi i Shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga një Administrator. Këtë detyrë do ta kryejë për periudhën e parë prej pesë vjetësh nga Zj. **Anxhela Belaj**, e bija e Dritan, lindur në Vlorë, më 11.10.1997, banuese në Rr. Rruga Bilal Sina, Pall. Salillari, Nr. 2 Kati 6, Tiranë, e identifikuar me anë të letërnjoftimit me nr. personal J76011076T, e cila do të ushtrojë të gjitha kompetencat për administrimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë, për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të



shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithëshme.

**PJESA VII
PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Neni 9

Prishja dhe likuidimi

- 9.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
 - (b) bashkimi me një shoqëri tjetër;
 - (c) vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
 - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 9.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

**PJESA VIII
TË PËRGJITHSHME**

Neni 10

Të tjera

- 10.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij akti themelimi ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga Gjykata Shqiptare.
- 10.2 Në lidhje me regjistrimin e Shoqërisë, autorizohen administratori i shoqërisë ose çdo person i caktuar prej tij për të ndërmarre procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë.
- 10.3 Ligji zbatues është ligji shqiptar.
- 10.4 Ky akt themelimi hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale.

ORTAKU THEMELUES

ANXHELA BELAJ

